


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË VLORE
NOTERE FLORA XH.ZOTO
Nr. 2543 REP.
Nr. 1392 KOL



KONTRATË SHITJE E KUOTAVE TË KAPITALIT

Në shoqërinë me Përgjegjësi të kufizuar

“ CO CASA ” SH.P.K

Në Fier, sot me datë 18.Korrik .2018 , përpara meje noteres Flora XH .Zoto , anëtare e Dhomës së Noterisë Vlore , me seli në Rrugen “Dervish Hekali” u paraqitën personalisht palët e mëposhtme :

SHITESI : Ilirjan Mertiri , shtetas shqiptar, lindur me 01/04/1979 në Fier, dhe banues në Tirane madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit (ID) Nr. 029161631 dhe numër personal H90401027L , ortak i shoqërisë “CO CASA ” Shpk, regjistruar në regjistrin tregtar të shoqërive tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 03/05/2013 me Nipt L32903405J , zotërues i 50 kuotave në kapitalin shoqëror të shoqërisë “ CO CASA ” Shpk, e cila përfaqëson 50% të Kapitalit Shoqëror.

BLERËSI: z. Arion Muçaj, atesia Bashkim, i datelindjes 19/04/1974, lindur ne Cakran Fier e banues ne Fier, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, njohur prej meje noteres me leternjoftim (ID) nr. 027635077/H40419023S.

Të cilët me vullnet të lirë e të plotë, më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitje kuotash në respektim të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ i ndryshuar, si më poshtë:

Shitësi Ilirjan Mertiri , është nje prej ortakeve ,zotërues i 50 kuote në Shoqërinë “CO CASA “ shpk, e cila është një shoqëri tregtare shqiptare e regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar të Shoqërive Tregtare, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 03/05/2013, me Nipt L32903405J

Nepermjet vendimit te dates 17.Korrik .2018 Asambleja e Ortakeve te shoqerise “Co Casa “shpk, ka miratuar shitjen e 50 % të kapitalit shoqëror në favor të ortakut të Arion Muçaj . Ortaku i shoqërisë “Co Casa “ shpk Ilirjan Mertiri ka rënë dakort që ky kapital te shitet kundrejt cmimit 50.000 lekë (pesedhjete mije leke),dhe blerësi Arion Muçaj ka shprehur vullnetin e tij për ta blerë këte kapital kundrejt cmimit prej 50.000(pesedhjete mije)leke .

Objekti i kontrates

Shitësi Ilirjan Mertiri , i cili është njeri prej ortakeve , zotërues i 50 kuotave në shoqërinë “Co Casa ” Shpk **transferon nëpërmjet shitjes** te gjithë kapitalin e zotëruar prej tij ne shoqerine „Co Casa“ shpk , dhe qe perben 50% te kapitalit te shoqerise „Co Casa „shpk, me vullnet të lirë e të plotë, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit 9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ , i ndryshuar, Statutin e Shoqërisë dhe vendimit të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë datë 17/07/2018 në favor të blerësit , ortakut Arion Mucaj .

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes së 50 kuotave te zotëruar nga ortakut i shoqërisë “Co Casa ” Shpk, Ilirjan Mertiri dhe që transferohen nëpërmjet kësaj kontrate në favor të ortakut z.Arion Mucaj , është 50.000 (pesedhjetë mijë) lekë.

Blerësi deklaron se ka paguar plotësisht çmimin e shitjes dhe shitësi deklaron se e ka marrë çmimin e plotë të shitjes dhe nuk ka asnjë pretendim.

Garancitë

Shitësi deklaron dhe garanton blerësin se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotes që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.


Heqja dorë nga të drejtat

Shitësi deklaron nën përgjegjësinë e tij personale, se heq dorë nga te gjitha te drejtat qe i takojne mbi zoterimin e 50 % te kapitalit me vlere 50.000(pesedhjetë mijë mijë) leke ne shoqerine Co Casa shpk dhe heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë mbi zotërimin e kuotave, kapitalit shoqëror, asetëve dhe të drejtave reale që po transferon nëpërmjet kësaj kontrate. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi gjithashtu zhvishet nga të gjitha detyrimet nga sot e në të ardhmen.

Të ndryshme

Pas realizimit të këtij transferimi me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi zhvishet teresisht nga zoterimi i kuotave qe po transferohen dhe **Bleresi Arion Mucaj** , behet pronar i ligjshem i 100 kuotave te shoqerise „Co Casa „shpk , me vlere te pergjithshme 100.000(njeqind mijë)leke , qe perfaqesojne 100 % te kapitalit te shoqerise “Co Casa”SHPK , dhe merr përsipër çdo të drejtë dhe detyrim që i takon nga zotërimi i këtyre kuotave në shoqërinë “Co Casa “ shpk.


Pjesët përbërëse të kontratës




Pjesët përbërëse të kësaj kontrate janë: *ekstrakti i shoqërisë "Co Casa" shpk, fotokopjet e dokumentave identifikuese të palëve në këtë kontratë, vendimi i Asamblese se Ortakeve të shoqërisë.*

Kjo kontratë u hartua nga unë noterja në katër ekzemplarë me vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, dhe pasi shpreh vullnetin e lirë e të plotë të palëve në këtë kontratë, nënshkruhet rregullisht sipas ligjit nga shitësi dhe blerësi përpara meje dhe unë noterja vërtetoj rregullshmërinë e tyre.

SHITËSI

Ilirjan Mecthari


BLERËSI

Arjan Mueq


**NOTERE
FLORA XH. ZOTO**

